


Ombrella amerikane fillon të mbyllet për Ballkanin



Faqe 3

PIKË me Veton Surroin: Bashkëbisedim me Michael Roth



Faqe 4-5-6

Irani pa vendim për marrëveshje, Trumpi kritikon sulmin izraelit në Bejrut



Faqe 7

Gjermania shfaq forcën ndaj debutuesve të Kuraçao



Faqe 17

e hënë • 15 qershor 2026

Numri 10394

# KOHA DITORE

www.koha.net



HETIMI PËR RASTIN "REÇAKU II" ÇON NË ARRESTIMIN E PESË SERBËVE TË DYSHUAR PËR KRIMIN NDAJ SHQIPTARËVE

## Arrestohen pesë të dyshuar për masakrën në Reçak, ishin pjesëtarë të Policisë së Serbisë

Pesë persona janë arrestuar në një operacion të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Speciale në kuadër të hetimeve për rastin "Reçaku II". Sipas autoriteteve, të dyshuarit kanë qenë pjesë e njësisë të Policisë së Serbisë që kanë marrë pjesë në aksionin e 15 janarit 1999 në fshatin Reçak, ku është kryer krim lufte ndaj popullsisë civile shqiptare

Arianita Hoti

PRISHTINË, 14 QERSHOR – Pesë serbë, të gjithë pjesëtarë të Policisë së Serbisë më 1999, janë arrestuar të dielën në kuadër të hetimeve që po zhvillohen për rastin e njohur si "Reçaku II".

Prokurori i Prokurorisë Speciale, Ilir Morina, ka deklaruar se në hetimet e zhvilluara deri tash janë identifikuar disa persona që kanë marrë pjesë në masakrën e 15 janarit të vitit 1999 në Reçak, ku janë vrarë 45 civilë shqiptarë.

"Me hetimet që i kemi zhvilluar që 6 muaj tashmë kemi arritur të identifikojmë edhe disa persona të cilët kanë qenë pjesë e njësisë të posaçme të Policisë së Serbisë në atë kohë, të cilat kanë marrë pjesë në aksionin e 15 janarit të vitit 1999 në fshatin Reçak. Pasi kemi siguruar prova të mjaftueshme, kemi konsideruar që ekziston dyshimi i bazuar lidhur me këta persona", ka thënë Morina.

Drejtori i Drejtorisë së Hetimeve për krimet e luftës, Bashkim Spahija, ka thënë se rasti i Reçakut është jashtëzakonisht i rëndë dhe ka kërkuar angazhim dinamik në kuptimin e hetimit dhe mbledhjes së provave për kryesit e mundshëm të kësaj vepre penale.

"Për ta plotësuar këtë informacion, përveç arrestimeve të të



dyshuarve gjatë këtij operacioni, hetuesit kanë arritur të gjejnë dhe të konfiskojnë një mori provash që ne konsiderojmë se janë relevante për rastin. Ndër to një armë, një uniformë ushtarake dhe policore, si dhe pjesë të ndryshme të uniformave, bexh i uniformës së Policisë së Serbisë, pranga, shufër e policisë", është shprehur Spahija.

Spahija ka bërë të ditur se është realizuar kërkim edhe për një ish-polic serb në Shtërpcë, por nuk

është gjetur në vendbanimin ku dyshohej dhe policia nuk ka arritur ta arrestojë.

Të arrestuarit janë ish-pjesëtarë të strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, ndërsa njëri prej tyre aktualisht punon në shërbimin postar në Serbi.

Për operacionin e Prokurorisë Speciale ka reaguar Lista Serbe e cila ka vlerësuar se arrestimet e fundit të serbëve përfaqësojnë, siç thuhet në deklaratë, një valë të re

frikësimi dhe presioni ndaj komunitetit serb në Shtërpcë dhe Gjilan.

"Ajo që po ndodh është dhunë e pastër institucionale dhe presion i motivuar politikisht ndaj popullit serb. Prej vitesh, përmes veprimeve të tilla, Prishtina po tenton të krijojë një narrativë të rrezikshme sipas së cilës, çdo serb që ka qenë në moshë madhore pas vitit 1999 mund të akuzohet për vepra të rënda penale pa asnjë bazë. Një qasje e tillë nuk bazohet në të drejta dhe prova, por

në stigmatizimin kolektiv të një populli të tërë", thuhet në reagimin e partisë që mbështetet nga Serbia.

E ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se krimet e luftës të kryera nga forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe po hetohen dhe ndiqen penalisht më shumë se kurrë më parë, duke theksuar se nuk do të ketë kompromis.

"Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë dhe për këtë fakt, të gjithë ata që kanë planifikuar, urdhëruar apo zbatuar krime kundër popullit tonë duhet të ballafaqohen me drejtësinë. Plaga e dhimbjes së familjeve të viktimave dhe e mbarë shoqërisë sonë mbetet e madhe, por drejtësia është detyrim institucional dhe moral që nuk parashkruhet", ka shkruar ai ndër të tjera.

Gjatë operacionit të së dielës janë sekuestruar pjesë të ndryshme të uniformave, pranga, 43 fishekë, maskë për mbrojtje nga mjetet kimike, dokumentacione që konfirmojnë angazhimet në MPB-në e Serbisë, katër telefona mobilë, mbi 30 mijë euro edhe mbi 400 mijë dinarë serbë.

Të arrestuarit pasdite kanë dalë para trupit gjykues ku pritet t'u caktohet masa e ndalimit. Seanca ka qenë e mbyllur për media.

© KOHA Ditore

KOSOVA E MALI I ZI VAZHDOJNË TË LIDHEN ME VETËM NJË PIKËKALIM KUFITAR

## Banorët kërkojnë hapjen e kufirit në Çakorr, institucionet heshtin

Rrezon Gashi

PEJË, 14 QERSHOR - Nga një aheng familjar në Mal të Zi, Husnija Beshkoviç, fundjavën e shkua po kthehej në shtëpinë e tij në Pejë.

Pjesën e fundit të rrugës e bëri në këmbë, pasi kalimi është i bllokuar me katër piramida betoni, të cilat, përveçse që pengojnë qarkullimin, shënojnë edhe kufirin mes Kosovës dhe Malit të Zi.

I lindur në Plavë e banor i Pejës, Beshkoviç thotë se mungesa e një pike kufitare në Çakorr dhe mos rregullimi i rrugës nga ana e Kosovës e kanë bërë më të vështirë lidhjen me vendlindjen.

Në anën e Malit të Zi, rruga është e asfaltuar.

"Po të mos ishin këto, ne i themi, piramida unë përditë do të vija. Por, që 27 vjet këto piramida janë këtu, këto bllokada, piramida i themi edhe me të vërtetë na kanë bllokuar

ekonomikisht, familjarisht e në të gjitha anët na kanë bllokuar me këto piramida", ka thënë Beshkoviç. Rruga lidh Pejë me Plavën.

Segmenti që kalon nëpër Grykën e Rugovës është i asfaltuar deri në fshatin Kuqishtë, ndërsa rreth dy kilometrat e fundit, deri në kufi me Malin e Zi, janë të paasfaltuara.

Sipas Beshkoviçit, mungesa e qarkullimit po dobëson gradualisht lidhjet mes shteteve në të dy anët e kufirit.

"Jo veç unë, por Peja, Deçani, Plava, Gucia i kemi lidhjet familjare, lidhjet tradicionale, lidhjet ekonomike dhe të gjitha këto lidhje, dita e ditës po hollohen", ka thënë ai.

Edhe Agron Nikçi nga Shtupeqi i Madh deklaroi se hapja e një pike kufitare në Çakorr do të sillte përfitime për banorët e 16 fshatrave të Rugovës.

"Kjo është një ngecje e një zhvillimi të hovshëm të trevës tonë sepse

nuk qarkullojnë turistë, nuk qarkullojnë familjarë, nuk lëvizin miq e nipa e dajë të cilët janë të lidhur nga Plava e Gucia, Vuçaj në atë pjesë ku janë nipat e dajat të lidhur me këtë pjesë tonë", ka thënë Nikçi.

Në prill, banorë të Rugovës, Plavës dhe Gucisë protestuan në të dy anët e kufirit, me kërkesën për funksionalizimin e rrugës.

KOHA ka dërguar pyetje në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Qeveri lidhur me arsyet e mos vendosjes së një pike kufitare në Çakorr dhe nëse ekzistojnë plane për hapjen e saj. Deri të dielën nuk ka marrë përgjigje.

Sipas Vityt Gacaferri, i cili udhëheq një kompani të turizmit malor, hapja e këtij pikë kalimi do të krijonte një korridor të rëndësishëm turistik dhe do të sillte përfitime të konsiderueshme ekonomike për të dy vendet.

"Hapja e këtij kufiri do të hapte një

grykë shumë të bukur për motoristë, për çiklistë qoftë me biçikleta elektrike apo biçikleta normale që do të jetë Pejë-Çakorr; një rrugë shumë e bukur, pastaj do vizitohej Plava me një liqe shumë të bukur dhe pastaj do të lidhet me Shqipëri me rrugën Vermosh-Shkodër që është një rrugë fenomenale. Ajo do të jetë një përvojë unike për motoristë edhe për çiklistë", ka thënë Gacaferri.

Aktualisht, mes Kosovës dhe Malit të Zi funksionon vetëm pikëkalimi kufitar Kullë-Rozhajë.

Për të udhëtuar nga Peja në Plavë përmes këtij kalimi duhen rreth 120 kilometra rrugë.

Hapja e një pike kufitare në Çakorr do ta shkurtojte distancën për afërsisht 50 kilometra.

Ministria e Infrastrukturës ka dhënë tender për hartimin e projektit të rikonstruktimit të rrugës Pejë-Kuqishtë-Çakorr.

"Fytyrat e lirisë" me portretet dhe kujtimet e paqeruajtësve



Në Galerinë e Arteve të Prishtinës kujtesa vjen nëpërmjet fytyrave. Rrëfëhet me shikime, heshtje dhe kujtime që vazhdojnë të jetojnë në ata që i kanë përjetuar. Ekspozita "Fytyrat e lirisë", e organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë dhe e kuruar nga Yllka Fetahaj, sjell para publikut portretet...

Faqe 13